

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë) ☐

QENDRA E MONITORIMIT TE MJEDISIT

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K92402036A

NUIS/NIPT

Zona kadastrale 2679, hyrja 2, apartamenti 39

Adresa

Tiranë

Albania

1050

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0694050210

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

elvis.xhaferri@gmail.com

E-mail

Administrator Elvis Xhaferri

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2025/06/03

Data (viti/muaji/dita)

0694050210

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-49204-05-27-2025

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Spitali Rajonal “Memorial” Fier

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

9410223

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

“Blerje paisje laboratorike për Shërbimin e Laboratorit të Anatomo Patologjisë dhe Shërbimin e Bankës së Gjakut ”

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2025/06/10

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme) ☐

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës) ☐

Tipi i kontratës

Mallra

Data e zhvillimit të procedurës

2025/06/10

Numri i njoftimit

CN/47193/05272025

Kodi CPV

42931100-2 - Centrifuga laboratorike dhe aks

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.) ☐

Neni 109 e vijues i Ligjit nr. 162/2020, date 23.12.2022 “Per prokurimin publik” dhe neni 94 3 vijues i VKM nr. 285, date 19.06.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar

2. Objekti i ankesës ☐

- Modifikim i dokumentave të tenderit ☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj. ☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. ☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate ☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Ne date 28/05/2025 ne sistemin elektronik te APP eshte publikuar procedura “Blerje paisje laboratorike për Shërbimin e Laboratorit të Anatomopatologjisë dhe Shërbimin e Bankës së Gjakut ” me nr. REF-49204-05-27-2025 nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal “Memorial” Fier

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Me poshte po paraqesim kerkesat ne lidhje me modifikimin e dokumentave te tenderit :

Kerkesa nr.1

Ne formularin e specifikimeve teknike shtojca 6 – artikulli nr 1 Paisje per parafinizimin e indeve – 1 cope kerkohen specifikimet:

Sistem i integruar me modul parafinizues dhe modul ftohës, i paisur me veshje antimikrobiale.

Kapaciteti i depozites se parafines jo me pak se 5 litra e pajisur me sistem filtrimi per parandalimin e futjes se mbetjeve te parafines ne shperndares, moduli ftohes me kapacitet minimal per akomodimin e 70 blloqeve.

Kapacitet ruajtës jo me pak se 300 kaseta indore dhe 280 kallepe parafine standarte.

Te jete I pajisur me LED qe ndricon ne menyre uniforme siperfaqen e punes dhe qe ofron mundesine e rregullimit te nivelit te ndricimit.

Temperature e rregullueshme e modulit ftohes per te reduktuar plasaritjen e blloqeve indore me diapazon nga -13oC deri ne – 2oC

Te jete I pajisur me kontrollor manual per rregullimin e shperndarjes se parafines.

Te jete I pajisur me zone per mbajten e mjeteve te pune si pincetat (jo me pak se 10) ne madhesi te ndryshme.

Te permbaje nje zone per heqjen e parafines se tepert nga kaseta

Ndërfaqja e përdoruesit me ekran me prekje.

Argumentimi jone:

Specifikimi “Te jete I pajisur me zone per mbajten e mjeteve te pune si pincetat (jo me pak se 10) ne madhesi te ndryshme” eshte i panevojshem dhe kufizon shume konkurencen ne kete procedure prokurimi . Kërkesa për të pasur një zonë për mbajtjen e mjeteve të punës si pincetat (jo më pak se 10 në madhësi të ndryshme) nuk është domosdoshmërisht thelbësore, për disa arsye praktike dhe teknike:

1. Nuk ndikon drejtpërdrejt në funksionin bazë të pajisjes

? Pajisja për parafinizimin e indeve ka funksionin kryesor: inkapsulimi i indeve në parafinë dhe ftohja e tyre. Mbajtja e pincetave është më shumë një lehtësi pune, jo një kërkesë që ndikon në cilësinë e procesit.

2. Mjetet e punës janë zakonisht personale ose të ndara nga pajisja

? Në shumë laboratorë, pincetat dhe instrumentet e ngjashme dezinfektohen, ruhen dhe

menaxhohen veçmas për të ruajtur sterilitetin dhe për të shmangur ndotjen e kryqezuar.

? Mbjajtja e tyre në vetë pajisjen mund të jetë e kufizuar për arsye higjienike.

? Në praktikë, mjetet si pincetat dhe spatulat ruhen shpesh në kontenerë të jashtëm sterilë, që pastrohen dhe menaxhohen veçmas për higjienë.

3. Standardet ndërkombëtare të pajisjeve të parafinizimit nuk e parashikojnë si kusht

? Prodhuarit kryesorë zakonisht ofrojnë mbajtëse aksesore si pjesë shtesë (opsionale), jo si komponent të integruar me kapacitet të specifikuar për 10 mjete.

4. Kufizon përzgjedhjen e furnitorëve

? Kërkesa për kapacitet specifik (10 pinceta) e bën pajisjen shumë të specializuar dhe mund të përjashtojë produkte që në thelb janë më cilësore, por nuk kanë këtë karakteristikë të veçantë.

5. Kushtëzimi me jo më pak se 10 është arbitrar

? Sasia minimale prej 10 pincetash nuk është e justifikuar për procesin standard të parafinizimit – zakonisht nevojiten 2-5 pinceta me madhësi të ndryshme.

? Modelet kryesore që kryejnë këto funksione kanë një hapësirë për të mbajtur : 6–8 pozicione.

? Kërkesa për jo më pak se 10 mund të përjashtojë pajisje të përparura që nuk përfshijnë njësi të tilla, pa ndonjë përfitim të qartë teknik.

Per sa me sipër kërkojmë të modifikohet kriteri në: “zone mbajtëse jo më pak se 6 pinceta” në mënyrë që mos të kufizoj operatorët që marrin pjesë në këto procedura prokurimi për një kërkesë krijësisht të pa nevojshme.

Kërkesa nr 2.

Në formularin e specifikimeve teknike shtojca 6 – artikulli nr 5 Paisje për ngjyrimin automatik të lamave – 1 cope janë vendosur specifikimet:

Paisja të jetë e përbërë nga jo më pak se 26 stacione reagentesh lehtësisht të aksesueshme të cilat duhet të jenë mjaftueshëm për të realizuar disa protokolle ngjyrimi në të njëjtën kohë.

Sistemi i hapur për përdorim të të gjitha solucionëve nga kompani të ndryshme.

Paisja të përmbajë softuer të lehtë në përdorim që nepermjet opsione të ofruara të mundësojë përdorimin e paisjes në kapacitetin e sajë të plotë dhe gjithashtu të ofrojë opsionin e sistemit të kontrollit të cilësive së reagentëve.

Të ofrojë mundësinë e prioritizimit të lamave urgjente pa kompromentuar lamat në proces dhe mundësinë e fillimit të zbatimit të procesit të punës në hapa të caktuara të protokollit.

Të jetë e pajisur me zone për tharjen e lamave e mjaftueshme për të përballuar volum të lartë të punës

Të ofrojë stativ për mbajtjen e lamave (jo më pak se 10 cope), dhe jo më pak se 30 vasketa me kapacitet mbajtës të reagentit jo më pak se 300 ml dhe kapake plastike për mbulimin e vasketave që të shmanget avullimi i reagentëve.

Aparati të jetë i pajisur me filtra karboni dhe të jetë i shoqëruar me 5 sete back up të filtrave.

Argumentimi jone:

Kriteri: “Paisja të përmbajë softuer të lehtë në përdorim që nepermjet opsione të ofruara të mundësojë përdorimin e paisjes në kapacitetin e sajë të plotë dhe gjithashtu të ofrojë opsionin e sistemit të kontrollit të cilësive së reagentëve”.

Ky kriter përmbledh dy pjesë:

1. Softuer i lehtë për përdorim:

o Ndërfaqe intuitive, me menu të qarta dhe të aksesueshme.

o Mundësia për të konfiguruar, modifikuar dhe ruajtur protokollin.

- o Ndhmon në optimizimin e punës dhe ul gabimet njerëzore.
- 2. Kontrolli i cilësisë së reagentëve:
 - o Nuk nënkupton analizë kimike të reagentëve.
 - o Konsiston në gjurmim dhe monitorim të përdorimit të tyre, përfshirë:
 - ? Regjistrimin e lot-it.
 - ? Alarm për datë skadence ose mungesë të reagentit.
 - ? Monitorimin e përdorimit të çdo vasketë.
 - ? Dokumentimin automatik për gjurmueshmëri.

Ky kriter nuk është i nevojshëm si kriter i detyrueshëm pasi:

1. Jo çdo pajisje e cilësisë së lartë e përfshin këtë funksionalitet
 - o Shumë pajisje të avancuara për ngjyrim automatik, që përmbushin standardet ISO dhe CE, nuk kanë sistem të integruar për kontroll cilësie të reagentëve në mënyrë të automatizuar.
 - o Zbatimi i kontrollit të reagentëve gjithmone bëhet manualisht në laborator, si pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë, jo vetë nga pajisja.
2. Mund të kufizojë konkurrencën
 - o Ky kërkim i veçantë (sistem kontrolli për reagentët) mund të përjashtojë prodhues që ofrojnë zgjidhje të shkëlqyera, por që nuk e kanë këtë opsion.
 - o Pajisjet e mëdha të kompanive kryesore botërore, shpesh nuk e ofrojnë këtë funksionalitet si të integruar.
3. Kriter funksional, jo thelbësor për vetë ngjyrimin
 - o Funksioni bazë i pajisjes është ngjyrimi i saktë dhe standard i lamave.
 - o Kontrolli i reagentëve nuk ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e ngjyrit në laboratorët ndjekin praktikën e duhura të dokumentimit dhe ruajtjes.

Ky kriter nuk është i domosdoshëm për menaxhim laboratorik, dhe si rrjedhojë nuk duhet të jetë detyrues, pasi nuk ndryshon funksionalitetin dhe cilësinë e pajisjes. Prandaj kërkojmë që ky kriter të hiqet nga specifikimet.

Kërkesa nr.3

Ne formuluarin e specifikimeve teknike shtojca 6 – artikulli nr 7. Pajisje për tharjen e slideve – 1 cope janë përcaktuar specifikimet:

Pajisja të jete e ndertuar nga treguesi dixhital i temperaturës dhe sipërfaqja e punës nga shufra të levizshme që mundësojnë vendosjen dhe tharjen e slideve

Sipërfaqja e ngrohjes të jete e veshur nga material që krijon kontrast për vizualizimin e seksioneve të parafines dhe gjithashtu veshje antimikrobale

Të jete I paisur me sistem për ngrohje të shpejte dhe ndricim LED

Argumentimi jonë:

Ne lidhje me specifikimin “Të jete I paisur me sistem për ngrohje të shpejte dhe ndricim LED”

Duke marrë në konsideratë se në laboratorët që ndriçimi në një laborator histologjie / patologjie – ku përfshihet dhe përdorimi i pajisjes për tharjen e slide-ve – duhet të sigurojë shikueshmëri të qartë, pa lodhje vizuale, për punë të saktë dhe të sigurt. Ndriçimi bazuar në EN 12464-1 dhe praktikën laboratorike ndërkombëtare në zonën e tharjes duhet të jete 500-750 Lux. Duke marrë në konsideratë se ndriçimi në këto mjedis laboratorik ka një ndricim mbi 500 Lux (sipas standarteve) po ju parashtrojmë me poshtë arsyet se pse ky kriter nuk është i domosdoshëm:

1. Ndriçimi ambient është i mjaftueshëm sipas standardeve laboratorike

Sipas standardit EN 12464-1 dhe praktikës laboratorike ndërkombëtare, për zonën pune si përgatitja dhe tharja e slide-ve kërkohet ndriçim minimal prej 500–750 lux.

Në këtë rast, me ndriçim ambient >500 lux, kemi tashmë një mjedis pune të ndriçuar në mënyrë optimale, që ofron kontrast të mjaftueshëm për të parë dhe manipuluar slide-t pa vështirësi.

2. Ndriçimi LED i pajisjes nuk ndikon në funksionin kryesor

Pajisja për tharjen e slide-ve ka funksion parësor të ngrohë dhe thajë slide-t në mënyrë uniforme – jo t'i ndriçojë ato.

LED-i i integruar nuk përmirëson cilësinë e tharjes apo integritetin e mostrës.

Në një ambient të ndriçuar mirë, drita shitesë nga LED-i bëhet e tepërt, ndonjëherë edhe e bezdisshme, veçanërisht në sipërfaqe reflektuese si metal apo qelq.

3. Ndriçimi LED shton kosto dhe mirëmbajtje të panevojshme

Integrimi i ndriçimit LED mund të rrisë kostot e pajisjes dhe të sjellë elemente të tjera elektrike që kanë potencial për defekte (llampa, qark, butona etj.).

Duke qenë se nuk ka ndikim në rezultatet laboratorike, ai nuk justifikon investimin shitesë.

4. Përdorimi i LED-it është vetëm ndihmës në kushte të ndriçimit të dobët

Ndriçimi LED mund të jetë i dobishëm vetëm në mjedise me ndriçim të pamjaftueshëm (me e vogël se 500 lux).

Me ndriçim ambient të përshtatshëm (me e madhe se 500 lux), përdorimi i tij është jo i nevojshëm.

Kërkesa për të integruar një burim ndriçimi në pajisje nuk sjell vlerë të shtuar në cilësinë e procesit, dhe për këtë arsye duhet të hiqet si specifikim i detyrueshëm teknik.

Kërkesa nr.4

Ne formularin e specifikimeve teknike shtojca 6 – artikulli nr 8. Termostat – 1 cope janë përcaktuar specifikimet:

-Inkubator standard me konveksion të drejtuar

-Intervali i temperaturës: +7°C poshtë temperaturës së ambientit deri në +300 °C

-Të jete i pajisur me ekran LCD

-Dera e brendshme të jete e përbërë nga xham i temperuar

-Të jete i pajisur me porte për USB

-Kontroll elektromekanik për ajrin e shkarkuar

-Volumi i brendshëm në intervalin 50-60 litra

Argumentimi i jone:

? Në lidhje me specifikimin “-Intervali i temperaturës: +7°C poshtë temperaturës së ambientit deri në +300 °C”, nuk ben kuptim pasi termostatet janë ngrohës, nuk mund të jenë edhe ftohës edhe ngrohës njëkohsisht. Në një laborator histologjie, patologjie apo biologjie mjekësore, ku përdoret një termostat (inkubator/furrë laboratorike) për përpunimin e mostrave biologjike (si inde të fiksuara, slide, kaseta parafine, etj.), temperaturat që përdoren janë si më poshtë:

Temperaturat tipike të përdorura:

Përdorimi Temperatura Tipike

Inkubimi i slide-ve ose indeve pas ngjyrosjes 37°C deri në 60°C

Tharja e slide-ve ose blloqeve të parafinës 50°C deri në 70°C

Ngrohja për tretjen e parafinës (opsionale) 60°C deri në 70°C

Inkubimi për teste imunohistokimike 37°C ose 45–60°C në varësi të protokollit

Inkubimi i medimeve të rritjes bakteriale (nëse aplikohet) 35–37°C

Tharje e materialeve laboratorike 70–100°C (rastet e veçanta)

Temperatura që nuk përdoren në asnjë rast:

? Poshtë temperaturës ambientale (p.sh. 18°C): nuk përdoret, pasi nuk ka nevojë për ftohje aktive në këtë lloj laborator.

? Mbi 100°C dhe deri në 300°C: rrallë ose kurrë nuk përdoret për qëllime të histologjisë apo ngjyrosjes. Kjo temperaturë përdoret për sterilizim në furat e ajrit të nxehtë, jo për termostatet e këtij tipi laborator.

Interval optimal për këtë laborator:

Nga +5°C mbi temperaturën ambientale deri në 80°C ose maksimumi 100°C

Ky interval është më se i mjaftueshëm për:

? Tharje e slide-ve

? Inkubim i solucioneve

? Aktivitetet rutinë të përpunimit histologjik

Pra, në këtë tip laborator, nuk është i nevojshëm një termostat që punon poshtë temperaturës ambientale apo deri në 300°C. Mjafton një pajisje që mbulon intervalin 30°C – 80°C, ose nëse kërkohet fleksibilitet më i lartë, deri 100°C.

Per sa me siper, kërkojme qe ky specifikim te ndryshoje ne: Nga +10°C mbi temperaturën ambientale deri në 100°C.

? Ne lidhje me specifikimin “volumi i brendshem ne intervalin 50-60 litra”, kërkojme qe ky specifikim te ndryshoje duke percaktuar vetem kufirin minimal 50 litra dhe jo te kufizohet ne kufirin e maksimal, pasi pjesa me e madhe e prodhuesve i kane termostetet mbi 60 litra, e cila per vete laboratorin eshte vetem avantazh nese e ka me te madh kapacitetin e volumit te brendshem.

Prandaj kërkojme qe ky specifikim te ndryshoje si vijon: volumi i brendshem jo me pak se 50 litra.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme ☐

Po ☐

Jo ☒

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

jo

7. Lista e informacionit konfidencial: ☐

jo

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. ☐

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

elvis.xhaferri@gmail.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Elvis Xhaferri